**L I G J**
**Nr.7534, datë 17.12.l991**

**PËR NJË SHTESË NË DEKRETIN NR.7463, DATË 31.1.1991 "PËR POLICINË FINANCIARE"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit " Për dispozitat kryesore kushtetutes " me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në dekretin nr.7463, datë 31.1.l991 " Për policinë financiare" pas nenit 7 shtohet neni 7/a me këtë përmbajtje:

"Punonjësit e Policisë Financiare gëzojnë statusin e ushtarakut dhe barazohen me punonjësit e ruajtjes së rendit publik".

Neni 2

Pas nenit 2, shtohet neni 2/a me këtë përmbajtje:

"Titullimi dhe emërimi i oficerëve (inspektor me arsim të lartë), bëhet me urdhër të Ministrit të Financave, ndërsa titullimi dhe emërimi i nënoficerëve (polic financier) bëhet me urdhër të drejtorit të Policisë Financiare.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.95, datë 25.12.l991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia**